



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 36 regjistër (JR)
Datë 04.12.2018

Nr. 20 i vendimit
Datë 31.07.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 31.07.2019, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar John Leonardo, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Dariel Sina.

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 61, datë 02.08.2018, për subjektin e rivlerësimit Gentjan Osmani.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 61, datë 02.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 61, datë 02.08.2018, të Komisionit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit prej vitit 2003 e në vijim ka ushtruar detyrën e prokurorit, dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Subjekti i rivlerësimit Gentjan Osmani i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë, meqenëse ka qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 13.11.2017, një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi pranë Komisionit nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 15.11.2017, raportin bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, dhe se nuk ka informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Për rrjedhojë, konstatohet përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Gentjan Osmani për vazhdimin e detyrës.

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***}, datë 25.01.2017.

³ Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, më datë 25.01.2017.

⁴ Dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme më datë 25.01.2017, sipas Raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, datë 04.01.2018.

5. Grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, si dhe rishikimit të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit¹ një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 61, datë 02.08.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 61, datë 02.08.2018, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.
 - i. *Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016:*
 - a. *Deklarimi në deklaratën “vetting” është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet ndër vite nuk kanë sjellë pasoja të tilla që ato të konsiderohen të pamjaftueshme në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.*
 - b. *Nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.*
 - c. *Nuk është kryer fshehje pasurie.*
 - d. *Nuk ka deklarime të rreme.*
 - e. *Subjekti nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit.*
 - ii. *Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.*
 - iii. *Pas shqyrtimit të raportit dhe denoncimeve në tërësi, nuk rezultuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, për pasojë nuk konstatohen indicie apo elemente që mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.*

- iv. *Për sa më sipër, trupi gjykues i KPK-së për subjektin e rivlerësimit ka konstatuar se ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale⁵.*

III. Shkaqet e ankimit

8. Pranë Komisionit, më datë 15.11.2018, është depozituar ankimi nr. {***} prot., i Komisionerit Publik Dariel Sina, kundër vendimit nr. 61, datë 02.08.2018. Ky ankim është bërë duke konsideruar rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim "ONM"), i cili me shkresën nr. {***} prot., datë 09.08.2019, i ka rekomanduar Komisionerit Publik apelimin e vendimit.
9. Në ankimin e paraqitur kundër vendimit të Komisionit nr. 61, datë 02.08.2018, bashkëlidhur tij Komisioneri Publik ka paraqitur një denoncim anonim nga publiku drejtuar ONM-së, i cili është përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe është regjistruar pranë tij me nr. {***} prot., datë 15.11.2018. Në ankimin e tij Komisioneri Publik kërkoi:
- marrjen në shqyrtim të shkaqeve të ankimit së bashku me denoncimin nga publiku, dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016 Kolegji të vendosë: Ndryshimin e vendimit nr. 61 datë 02.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gentjan Osmani.
10. Shkaqet e ankimit të cilat i referohen kriterit të kontrollit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

10.1 Subjekti i rivlerësimit me provat e paraqitura gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, nuk ka mundur të shpjegojë e provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të, si dhe gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me:

- (i) mungesën e ndonjë dokumenti ligjor justifikues, i cili të vërtetojë dhe të provojë ekzistencën e marrëdhënies së huas prej 20.000 eurosh me shtetasin A.Q., që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit 1+1, me sipërfaqe 72 m², si dhe shlyerjen e saj;
- (ii) aftësinë financiare të huadhënësit A.Q. për kursimin dhe dhënien e huas në vitin 2009 subjektit të rivlerësimit, shumë prej 20.000 eurosh, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj;
- (iii) mungesën e burimeve të ligjshme financiare në vitin 2009 për të realizuar kursimin e deklaruar dhe pagesat e kryera atë vit për shlyerjen e kësteve për blerjen e apartamentit me shoqërinë "{***}" ShPK;
- (iv) mungesën e të ardhurave të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar pagesat për blerjen e apartamentit dhe shlyerjen e huas në vitet 2011, 2012, 2013;
- (v) personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të cilët nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shumë e deklaruar

⁵ Komisioni ka administruar me nr. {***} prot., datë 04.01.2018, shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme, me objekt: "Dërgim i raportit të rivlerësimit për subjektin Gentjan Osmani", si dhe një kopje të akteve mbi të cilat është bazuar ky raport.

si të dhuruar vajzës së tyre (prej 1.500.000 lekësh), duke mos provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe me pretendimin se dhurimi nuk rezulton të jetë konfirmuar dhe provuar si fakt.

10.2 Për pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf 3”, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk mbulon me të ardhura të ligjshme realizimin e kursimeve dhe blerjen e këtij automjeti në vitin 2005.

10.3 Për shqyrtimin e denoncimit publik të përcjellë nga ONM-ja, pasi prej këtij shqyrtimi, sipas Komisionerit Publik, mund të rezultojnë fakte dhe rrethana të cilat mund të përbëjnë shkak për rivlerësimin edhe të dy kritereve të tjera, të figurës dhe të aftësive profesionale.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

I) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit dhe të Komisionerit Publik kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e tyre, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentjan Osmani, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet e Komisionerit Publik ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

II) Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi, Komisioneri Publik, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

III) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 61, datë 02.08.2018, për subjektin e rivlerësimit Gentjan Osmani, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve dhe të publikut. Trupi gjykues, pasi dëgjoji shpjegimet e palëve lidhur me ankimin dhe kërkimet e tyre, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me

vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të hetojë si më poshtë.

- (i) Mundësinë e personit të lidhur, z. A.Q, për të krijuar e kursyer shumë prej 20000 eurosh, të dhënë hua subjektit të rivlerësimit në vitin 2009.
- (ii) Mundësinë e personave të tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme e kursyer shumë prej 1.500.000 lekësh, dhuruar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në vitin 2009.
- (iii) Situatën faktike që lidhet me mosdeklarimin në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2005 të automjetit tip “Volkswagen Golf” dhe aftësinë paguese të subjektit për ta blerë atë në këtë vit;
- (iv) Tri rrethana që bëhen të njohura në denoncimin bashkëlidhur ankimit dhe konkretisht:
 - në lidhje me faktin nëse është zhvilluar ndonjë hetim penal ndaj personit B. K., pronar i automjetit tip “Mercedes Benz”, dhënë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, dhe rolin e subjektit në një rast të tillë;
 - në lidhje me rolin dhe vendimet e marra prej subjektit të rivlerësimit në çështjen penale që u përket të pandehurve S.Ç., E.B. e S.S;
 - në lidhje me udhëtimin në Turqi të subjektit të rivlerësimit së bashku me shtetasin V.M., me cilësinë e avokatit mbrojtës të një shtetasi turk, në kohën kur subjekti i rivlerësimit ishte prokurori i caktuar me hetimin e çështjes penale në ngarkim të këtij shtetasi.

14. Trupi gjykues shqyrtoi aktet e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga Kolegji, si edhe aktet shpresore e prapësimet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit si më poshtë.

B. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

15. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit ai ka pretenduar në ankim se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë bindshëm me provat e paraqitura në hetimin administrativ në Komision burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe të personave të tjerë të lidhur me të, burim i cili ka shërbyer për të blerë pasurinë shtëpi banimi, me sipërfaqe 96 m² + 12 m² ambiente të përbashkëta, me adresë: “{***}, Tiranë, fituar me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 13.01.2017, me vlerë 82.000 euro, për të cilën në deklaratën *vetting* ka deklaruar se si burim i krijimit të saj ka shërbyer vlera e përfituar nga shitja e apartamentit 1+1, me sipërfaqe 72 m², prej 80.000 eurosh, Kolegji konstatoi rrethanat e faktit si më poshtë.
16. Pasuria apartament 1+1, me sipërfaqe 72 m², blerë në vitin 2009 prej subjektit të rivlerësimit nuk gjendet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë pronë në vitin 2016 dhe paratë e përfituara nga ky veprim juridik kanë shërbyer si një prej burimeve për blerjen e banesës në të cilën ai banon sot dhe e cila është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si apartament me sipërfaqe 96 m², i ndodhur në Kompleksin “{***}”, i regjistruar si pasuria nr. {***}, volumi {***},

faqe {***}, Zona Kadastrale {***} Tiranë. Kjo pasuri⁶ ka qenë objekt verifikimi e kontrolli në kuptim të procesit të rivlerësimit pikërisht për shkak se ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament që është sot në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

17. Në lidhje me apartamentin 1+1, prej 72 m², të blerë në vitin 2009, në deklaratën periodike të këtij viti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:
- *Apartament banimi me sipërfaqe 72 m², porositur me aktmarrëveshjen nr. {***} rep., datë 02.02.2009, në shumën 67680 euro, nga të cilat paguar për vitin 2009, 47680 euro, për shkak të shtyrjes së punimeve. Burimi i pagesës deri më 31.12.2009 janë: 1) të gjitha kursimet cash në vite (së bashku me bashkëshorten); 2) një pjesë e huas në shumën 20.000 (njëzet mijë) euro; 3) të gjitha të ardhurat nga dhurimi për bashkëshorten, në shumën 1.500.000 lekë.*
 - Në seksionin ku deklarohen detyrimet financiare, subjekti ka deklaruar: *Kontratë huaje pa afat, në formë shkresore, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi, e lidhur më datë 21.08.2009, për marrjen e një huaje në shumën 20.000 euro, me interes vjetor 5%.*
 - Në deklaratën periodike të vitit 2011, lidhur me shlyerjen e huas, subjekti ka deklaruar: *Kontratë huaje e lidhur më datë 21.08.2009 për marrje huaje 20.000 euro, me një interes vjetor prej 5%; shlyer 7.000 euro, mbetur pa shlyer 13.000 euro pa interesa.* Gjithashtu në këtë vit ai ka deklaruar edhe shlyerjen e detyrimit në shumën prej 4000 eurosh për llogari të blerjes së apartamentit.
 - Në deklaratën periodike të vitit 2012, lidhur me shlyerjen e huas subjekti ka deklaruar: *Kontratë huaje e lidhur më datë 21.08.2009 për marrje huaje 20.000 euro, me një interes vjetor prej 5%; shlyer 5.000 euro, mbetur pa shlyer 8.000 euro pa interesa.*
 - Në deklaratën periodike të vitit 2013 për shlyerjen e huas subjekti ka deklaruar: *Kontratë huaje e lidhur më datë 21.08.2009 për marrje huaje 20.000 euro, me një interes vjetor prej 5%; shlyer 8.000 euro, detyrim i mbetur (0).*
18. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioneri Publik ka parashtruar disa shkaqe ankimi. Së pari, ai ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë me dokumentacion ligjor marrëdhënien e huas mes tij dhe djalit të tezes së tij, z. A.Q., për dhënien hua të shumës prej 20000 eurosh në vitin 2009, shumë e cila ka shërbyer për financimin e çmimit të blerjes së shtëpisë së porositur prej subjektit në vitin 2009 dhe se Komisioni padrejtësisht e ka konsideruar të provuar këtë fakt. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar ndaj këtij shkak, me pretendimin se rezulton e provuar që kjo marrëdhënie ka ekzistuar sipas deklaratës noteriale të datës 21.08.2009, e cila ka qenë e deklaruar edhe në deklaratën e tij periodike të pasurisë të vitit 2009.
19. Në analizë të këtij shkak ankimi, Kolegji konstaton se marrëdhënia e huas mes subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur, z. A.Q., ka qenë e deklaruar si e tillë që në deklaratën periodike të vitit 2009. Në këtë deklaratë subjekti e ka deklaruar këtë marrëdhënie si në rubrikën në të cilën përshkruhet pasuria dhe burimet e saj, si një prej burimeve të krijimit të pasurisë apartament, ashtu edhe në rubrikën në të cilën deklarohen detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë. Në këtë të fundit, subjekti ka deklaruar jo vetëm ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, por edhe dokumentin shkresor

⁶ Apartamenti 1+1, me sipërfaqe 72 m², blerë në vitin 2009.

provues të saj, i cili, sipas këtij deklarami, është një kontratë huaje në formë shkresore pa afat, e lidhur në datën 21.08.2009, për shumën 20000 euro. Në deklaramet periodike të viteve të mëpasshme, 2011, 2012 e 2013, subjekti ka deklaruar shlyerjen e saj sipas kësteve përkatëse.

20. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti gjatë procesit ka paraqitur përpara Komisionit së bashku me përgjigjet e tij të datës 29.04.2018, dokumentin shkresor të nënshkruar, të titulluar “Kontratë huaje”, të datës 21.08.2009, në të cilin palët, subjekti i rivlerësimit dhe z. A.Q. konfirmojnë dhënien e kësaj shume hua. Gjithashtu, nga verifikimet në sistemin TIMS, rezulton i provuar fakti se në datën 21.08.2009, personi tjetër i lidhur, z. A.Q., ka qenë i ndodhur në Shqipëri. Pra, në gjendje të nënshkruante kontratën e sipërpërmendur.
21. Në lidhje me mënyrën e transferimit të parave nga shtetasi A.Q te subjekti i rivlerësimit, Kolegji shqyrtoi rrethanat në këndvështrim të kuadrit ligjor në fuqi që rregullonte situatën e mësipërme. Referuar deklaramete të subjektit, rezulton se kjo shumë i është dorëzuar subjektit në kohën e përpilimit të kontratës së huas, kohë në të cilën ky shtetas ka qenë në Shqipëri. Sipas deklaramete të subjektit të rivlerësimit në seancë publike, kjo shumë është transportuar në gjendje *cash* nga Italia ku ai ka jetuar, në Shqipëri, gradualisht përgjatë vizitave të tij periodike pranë familjes së tij.
22. Kolegji analizoi rrethanat e faktit të cilat kanë rezultuar nga hetimi, në këndvështrim të dispozitave ligjore që rregullojnë situatën e mësipërme. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se kontrata e huas e formalizuar në formë shkresore të thjeshtë, është një formë e lejuar për të provuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, respektivisht nenet 1050-1055, të cilat nuk parashikojnë për efekt të vlefshmërisë së saj një formë të caktuar shkresore, duke e përfshirë këtë veprim juridik te kontrata joformale. Gjithashtu vetë neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënieje, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*, duke pranuar se marrëdhëniet e pretenduara sipas kësaj dispozite jo detyrimisht duhet të jenë të formalizuara në një formë të caktuar, sigurisht përveç rastit kur forma e tyre është e detyrueshme për vlefshmërinë e tyre, sipas përcaktimit të Kodit Civil, për sa kohë që për provimin e ekzistencës së tyre, në kuptim të këtij procesi, kërkohet konfirmimi i personit tjetër të lidhur.
23. Gjithashtu Kolegji bindet se deklarimi i subjektit dhe i personit tjetër të lidhur për mënyrën e transferimit të parave në Shqipëri nga Italia, është kryer gradualisht, në shuma më të vogla se shuma prej 1.000.000 lekësh, për të cilën individët kanë detyrimin të bëjnë deklaramet në pikat kufitare, sipas parashikimeve të nenit 17 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, duke qenë se kjo formë e transferimit të parave është një mënyrë e përdorur zakonisht nga emigrantët shqiptarë në vitet e kaluara.
24. Përpos kësaj situatë ligjore, Kolegji konsideron edhe marrëdhëniet e posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe z. A.Q., të cilët rezultojnë të jenë në lidhje gjinore. Në këtë këndvështrim, Kolegji beson ekzistencën e kësaj marrëdhënieje edhe për faktin se ndihma

financiare ka konsistuar në një hua dhe jo dhurim, pra personi tjetër i lidhur nuk ka hequr dorë nga pronësia mbi paratë e dhëna subjektit, por vetëm i ka huazuar ato në formën e një ndihme, duke i rimarrë përsëri në përmbushje të afateve të parashikuara në kontratë. Ky arsyetim bëhet i vlefshëm dhe relevant për çështjen, duke qenë se personi tjetër i lidhur rezultoi të ketë të ardhura që vijnë nga punësimi dhe që sigurojnë një jetesë modeste, rrethana të cilat mund të kishin një trajtim të ndryshëm në rast se do të kishim të bënim me dhurim të pasurisë. Gjithashtu fakti që personi tjetër i lidhur është treguar aktiv gjatë procesit, duke vënë në dispozicion dokumentacionin që provon të ardhurat e tij, i cili konsiderohet si dokumentacion/akte që përmban të dhëna personale, çmohet se përmbush, krahas kontratës shkresore, kriterin e konfirmimit të kësaj marrëdhënieje sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, duke analizuar situatën faktike të provuar dhe dispozitat ligjore përkatëse, Kolegji çmon se pretendimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, nuk qëndron.

25. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit Komisioni pa të drejtë ka njohur aftësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. A.Q., për kursimin e vlerës së dhënë hua prej 20000 eurosh dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë këtë fakt, Kolegji vlerësoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili u mbrojt me prezantimin e të ardhurave të ligjshme të siguruara nga puna e personit tjetër të lidhur në Itali dhe dokumentacionin shoqëruar që provon këtë fakt të sjellë në cilësinë e provës gjatë gjykimit në Kolegj në seancën gjyqësore publike të datës 11.07.2019.
26. Në lidhje me këtë shkak ankimi, nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë gjykimit të kësaj çështjeje në Kolegj, rezultoi se shtetasi A.Q. ka jetuar si emigrant në Itali që prej vitit 1999, fakt që rezultoi i provuar me lejen e qëndrimit të lëshuar nga autoritet vendore të shtetit italian⁷, në datën 13.01.1999. Sipas disa kontratave të punësimit të paraqitura përgjatë hetimit administrativ, rezultoi se në vazhdimësi gjatë këtyre viteve, personi tjetër i lidhur ka figuruar të ketë qenë i përfshirë në marrëdhënie të ndryshme punësimi, prej të cilave të ketë siguar të ardhura. Për të provuar vlerën e këtyre të ardhurave të realizuara në vite nga puna e personit tjetër të lidhur në këtë shtet, janë paraqitur prej subjektit të rivlerësimit certifikata e të ardhurave CUD, për periudhën 2002-2008, duke qenë se huaja është dhënë në vitin 2009, për pasojë periudha pas vitit 2008 ishte e irelevante për të vlerësuar të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur.
27. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur gjatë procesit gjyqësor prej subjektit të rivlerësimit, në seancën gjyqësore publike të datës 11.07.2019, u morën me cilësinë e provave “Ekstrakti i llogarisë së sigurimeve shoqërore”, i lëshuar nga Instituti Italian i Sigurimeve Shoqërore i vitit 2019, ku jepen të dhëna për punësimin e z. A.Q. nga viti 1999 deri në vitin 2018; vërtetimi i lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave e shtetit italian, i datës 15.02.2019, për shtetasin A.Q., për të cilin thuhet se nuk ka detyrime të papaguara lidhur me taksat në zonën e tij të rezidencës ({{***}}). Bazuar në këtë dokumentacion provues, Kolegji arriti të përcaktojë se vlera e të ardhurave të ligjshme të krijuara prej

⁷ *Ministria e Brendshme, Departamenti i Sigurisë Publike - Questura di Caserta.*

personit tjetër të lidhur përgjatë kësaj periudhës 2002-2008, shkon në vlerën prej 91.470 eurosh⁸. Në këtë vlerë është arritur pas përlllogaritjes e zbritjes së vlerave që u korrespondojnë pagesës së tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe taksave të identifikueshme nëpërmjet këtij dokumentacioni. Kolegji gjithashtu vlerësoi se vlera minimale për të jetuar në shtetin italian për personin tjetër të lidhur dhe bashkëshorten e tij, për vitet 2002-2008, referuar të dhënave të gjendura në faqen zyrtare të Agjencisë Italiane të Statistikave (ISTAT Italy), arrin në vlerën 51.640⁹ euro.

28. Kolegji vlerësoi faktet e mësipërme në kuadër të pretendimit të Komisionerit Publik se, në këndvështrim të këtyre të dhënave, personi tjetër i lidhur nuk kishte mundësi të kursente shumën e dhënë hua subjektit të rivlerësimit, duke analizuar situatën faktike në kuptim të përcaktimit të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Sipas kësaj dispozite, e cila parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka barrën të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie e cila i dhurohet ose i jepet hua prej personit tjetër të lidhur, në këtë rast, të shumës prej 20.000 eurosh.
29. Në kuptim të kësaj dispozite dhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit¹⁰, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se analizimi i rrethanave të faktit në rastin konkret duhet të fokusohet në dy aspekte.

Së pari, nëse provohet se personi tjetër i lidhur mundej t'i realizonte këto të ardhura (shumën prej 20.000 eurosh) me burime të ligjshme. Për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, trupi gjykues merr në konsideratë faktin se përgjatë periudhës 2002-2008, e cila u konsiderua si e arsyeshme të merrej parasysh si për shkak të faktit se për këtë periudhë u paraqit dokumentacion ligjor provues për të ardhurat, por edhe për shkak të një arsyetimi logjik se verifikimi i të ardhurave të personit tjetër të lidhur jo detyrimisht duhet të përfshijë të gjithë periudhën e punësimit të tij, por aq sa është e përshtatshme/nevojshme dhe proporcionale në lidhje me shtrirjen në kohë të krijimit të pasurisë, për sa nuk rezultojnë pretendime apo fakte që e lidhin fitimin e saj me një moment të caktuar kohor, me qëllim provimin e ligjshmërisë së burimit për vlerën që është objekt dhurimi apo huaje. Sipas analizës së kryer në këtë këndvështrim, rezultoi se personi tjetër i lidhur kishte realizuar deri në momentin e dhënies së huas të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës, shumën prej 91.470 eurosh, shumë e cila përfshin shumën prej 20.000 eurosh të dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

⁸ Për të përlllogaritur të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. A. Q., për periudhën 2002-2008, janë marrë në konsideratë të ardhurat bruto sipas "Ekstraktit të sigurimeve shoqërore", të cilat rezultuan në vlerën 116.591 euro, taksat sipas deklaratave vjetore CUD të dorëzuara gjatë hetimit administrativ në masën 15.619 euro, si dhe siguracionet në masën 9.502 euro. Nga të ardhurat bruto janë reduktuar taksat dhe tatimet përkatëse dhe vlera neto e tyre ka rezultuar 91.470 euro.

⁹ Janë përfshirë dhe kostot e jetesës të marra nga faqja zyrtare e Agjencisë Italiane të Statistikave, (Istat Italy) për kategorinë e shtetasve italianë në nivelin e varfërisë. Përlllogaritja është bërë për periudhën 2002-2008, duke konsideruar që z. A.Q ka jetuar i vetëm dhe vetëm në vitin e fundit i është bashkuar e shoqja, pas martesës. Kostot e jetesës janë përlllogaritur 51.640 euro.

¹⁰ Shih vendimet e Kolegjit nr. 12/2018 (JR), nr. 14/2019 (JR) dhe nr. 15/2019 (JR).

Së dyti, nëse pas një vlerësimi logjik dhe të përgjithshëm të çdo rasti, personi tjetër i lidhur kishte mundësi t'ia jepte hua këtë shumë subjektit të rivlerësimit. Për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, trupi gjykues vlerësoi të analizojë faktin nëse me këto të ardhura të realizuara prej personit tjetër të lidhur, a mundej ai sipas një vlerësimi të arsyeshëm të të gjitha rrethanave, të jepte hua shumën e pretenduar. Pjesë e këtij vlerësimi, sipas trupit gjykues, duhet të jetë raporti që krijohet mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve për jetesë të personit tjetër të lidhur për periudhën që analizohet, për sa kohë që nuk rezulton ndonjë pretendim tjetër i subjektit të rivlerësimit se ai realizonte të ardhura prej ndonjë burimi tjetër të ligjshëm, por të paverifikuar.

30. Në këtë kuptim Kolegji çmon se për të konkluduar nëse shumën e dhënë hua personi tjetër i lidhur, z. A.Q., kishte mundësinë ta ruante, duhet të zbritet nga shuma prej 91.470 eurosh që janë të ardhurat e tij shuma prej 51.640 eurosh, e cila është shuma e analizuar si shpenzim jetik bazik për personin tjetër të lidhur. Në përfundim të kësaj analize, rezultoi se personi tjetër i lidhur kishte mundësi të kursente shumën prej 39.829 eurosh.
31. Kolegji vlerëson se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.
32. Bazuar në analizën e mësipërme, Kolegji arrin në konkluzionin se personi tjetër i lidhur justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 20.000 eurosh të dhënë hua subjektit të rivlerësimit, konkluzion i cili kënaq kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, Kolegjit e gjen të pabazuar këtë shkak ankimi të Komisionerit Publik.
33. Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit Komisioni ka gabuar kur ka pranuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme në vitin 2009 për të financuar pagesën e shumës prej 46.687 eurosh për shoqërinë “{***}” ShPK, si pjesë e çmimit të porositjes së apartamentit, trupi gjykues i Kolegjit pasi dëgjoji prapësimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit vlerë provuese dominuese për këtë shkak duhet marrë deklarata periodike e vitit 2009, si dhe shqyrtoi të gjitha rrethanat që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë gjykimit në Kolegji, arriti në konkluzionin se edhe ky shkak ankimi nuk gjendet i bazuar. Siç u përshkrua më sipër, subjekti i rivlerësimit ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK aktmarrëveshjen e datës 02.02.2009 për porositjen e një apartamenti me sipërfaqe 72 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, për një çmim prej 67.680 eurosh. Sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën periodike të viti 2009, nga kjo shumë ai ka shlyer brenda këtij viti shumën prej 47.680 euro. Si burim për pagesën e kësaj shume, subjekti ka deklaruar se ka përdorur të gjitha kursimet në vite të tij e të bashkëshortes, personit të lidhur, znj. M.N., një pjesë të huas marrë prej personit tjetër të lidhur, z. A.Q., dhe shumën prej 1.500.000 lekësh, dhuratë bashkëshortes nga prindërit e saj.
34. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 22.1.2018, i ka kërkuar shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK informacion të detajuar mbi mënyrën dhe kështet e shlyerjes së apartamentit të porositur nga subjekti i rivlerësimit, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Shoqëria “{***}” ShPK, në përgjigje, ka konfirmuar faktin

se subjekti i rivlerësimit ka shlyer apartamentin sipas 6 mandatpagesave të paraqitura¹¹, duke sqaruar se është përjashtuar nga detyrimi shuma prej 4.000 eurosh, si penalitet i aplikuar ndaj shoqërisë për dorëzimin me vonesë të pasurisë. Referuar mandatpagesave të përcjella prej shoqërisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shlyer çmimin total prej 63.680 eurosh.

35. Komisioneri Publik ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit në lidhje me konkluzion se subjekti kishte pasur mundësi të justifikonte me burime të ligjshme pagimin e shumës së deklaruar, prej 47.680 eurosh, në vitin 2009, pasi referuar kësteve të pagesës sipas mandatpagesave të mësipërme, rezulton se subjekti nuk kishte mundësi të paguante dy këstet, këstin prej 15.000 eurosh në datën 31.01.2009 dhe këstin prej 32.680 eurosh në datën 21.03.2009, si dhe të përballonte jetesën e të kursente në fund të vitit shumë prej 1.400.000 lekësh.
36. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar këtë pretendim pas kalimit të barrës së provës në Komision, por edhe përgjatë gjykimit, duke kontestuar vërtetësinë e mandatpagesës nr. {***}, e cila pasqyron pagesën e shumës prej 32.680 eurosh në datën 31.03.2009. Ai ka shpjeguar se mandati i arkëtimit me nr. {***}, datë 21.03.2009, është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga përfaqësuesit e shoqërisë “{***}” ShPK dhe është i panënshkruar prej subjektit të rivlerësimit. Ai prezantoi në gjykim një kalendar pagesash të ndryshëm nga ai i paraqitur nga shoqëria, e cila në thelb mbështet deklarinin e subjektit të rivlerësimit të bërë në deklaratën periodike të vitit 2009, se shlyerja e shumës prej 47.680 eurosh ishte bërë deri në datën 31.12.2009.
37. Kolegji analizoi këtë shkak ankimi në raport me të gjitha rrethanat që kanë rezultuar të provuara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe duke konsideruar në këtë analizë edhe shpjegimet e deklarinimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat janë një prej mjeteve të kërkimit të provës për efekt të këtij procesi¹². Për t’i dhënë përgjigje këtij shkak ankimi, Kolegji çmoi se para tij u shtruan për zgjidhje këto çështje:
1. përcaktimi i kohës së kryerjes së pagesës së shumës prej 47.680 eurosh përgjatë vitit 2009;
 2. përcaktimi i burimeve financiare të përdorura për shlyerjen e kësaj shume në vitin 2009.
38. Për çështjen e parë, Kolegji konstatoi se në lidhje me kohën në të cilën është kryer prej subjektit të rivlerësimit pagesa prej 47.680 eurosh, dalin në pah disa të dhëna prej akteve të ndryshme. Nga deklarinimet e subjektit në deklaratën periodike të vitit 2009, rezulton e dhëna se kjo shumë është shlyer përgjatë vitit 2009, deri në 31.12.2009. E njëjta periudhë e pacaktuar kohore është përfutuar edhe prej prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, përgjatë shpjegimeve të dhëna në procesin gjyqësor të zhvilluar në Kolegji, si edhe përgjatë shpjegimeve të tij pas kalimit të barrës së provës pas përfundimit të hetimeve

¹¹ Pagesë në arkë 15.000 euro, datë 31.1.2009, sipas faturës nr. {***}; pagesë në arkë 32.680 euro, datë 21.3.2009, sipas faturës nr. {***}; pagesë në arkë 5.000 euro, datë 16.1.2010, sipas faturës nr. {***}; pagesë në arkë 3.000 euro, datë 28.5.2010, sipas faturës nr. {***}; pagesë në arkë 4.000 euro, datë 25.6.2010, sipas faturës nr. {***}; pagesë në arkë 4.000 euro, datë 02.7.2010, sipas faturës nr. {***}.

¹² Neni 49 i ligjit nr.84/2016 parashikon se: 1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: [...] b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku;

paraprake në Komision. Subjekti, siç u përmend edhe më lart, ka deklaruar se ai është dakordësuar për shlyerjen e këtij detyrimi sipas një kalendari i cili kushtëzohet, sipas tij, nga mundësitë e tij financiare për çdo këst pagese. Për mënyrën e shlyerjes së çmimit të sipërmarrjes, konstatohet se ka pasur edhe një parashikim kontraktor në aktmarrëveshjen e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për porosinë e apartamentit, sipas të cilës këstet do të paguheshin përkatësisht 15.000 euro me hartimin e aktmarrëveshjes, 25.000 euro deri në muajin maj të vitit 2009, 15.000 euro deri në muajin dhjetor 2009, si dhe do të paguheshin 12.680 euro me dorëzimin dhe mbarimin e punimeve dhe marrjen e lejes së shfrytëzimit deri më 31.05.2010.

39. Nga përgjigjja që shoqëria “{***}” ShPK ka përcjellë pranë Komisionit, ka rezultuar se pagesat janë kryer sipas një kalendari tjetër dhe konkretisht: 15.000 euro më datë 31.1.2009; 32.680 euro më datë 21.3.2009; 5.000 euro më datë 16.1.2010; 3.000 euro më datë 28.5.2010; 4.000 euro më datë 25.6.2010, 4.000 euro më datë 02.7.2010. Në përgjigjen që shoqëria “{***}” ShPK ka kthyer pas kërkesës së datës 20.07.2018 të subjektit të rivlerësimit, është deklaruar: *Bazuar në marrëdhëniet e mirëbesimit që ne kemi ndërtuar me njëri-tjetrin në lidhjen e kësaj aktmarrëveshjeje, pamundësinë tuaj fizike për të qenë prezent gjatë orëve të punës së administratës së firmës sonë dhe duke pasur në konsideratë në atë kohë edhe parashikimet kontraktore të kontratës datë 02.02.2009, nga ana jonë është lejuar faturimi i shumës në mandatin e arkëtimit nr. {***}, prej 32.680 eurosh (kësti më i madh) të shkruhet e plotë, realisht nga ana juaj kjo shumë është arkëtuar deri në fund të vitit 2009 [...], duke konfirmuar në këtë mënyrë deklarimet që ka bërë subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me këtë fakt.*
40. Vlerësimi i parë që bën Kolegji në këtë situatë lidhet me faktin se përcaktimi i kohës së shlyerjes së shumave, sipas aktmarrëveshjes së datës 02.02.2009, është një parashikim i palëve për mënyrën e shlyerjes së çmimit për këstet e mbetura pa paguar, përjashtojtë këstin e parë të paguar para lidhjes së aktmarrëveshjes, që do të ndodhë në të ardhmen, por jo konfirmimi i një rrethane faktike që ka ndodhur tashmë. Në këtë kuptim, këto afate mund të konsiderohen si orientuese për palët nënshkruese dhe nuk kanë fuqinë e provueshmërisë së këtij kalendari për shlyerjen e shumave, për sa kohë flitet për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen. Sigurisht, që palët udhëhiqen nga parimet e mirëbesimit në zbatimin e detyrimeve kontraktore, por ato mbeten përsëri të lira të ushtrojnë të drejtat e tyre kontraktore, për sa kohë ka mirëkuptim e vullnet të përbashkët, siç konfirmon edhe shoqëria “{***}” ShPK në shkresën e saj të datës 20.07.2018. Mandatpagesat e lëshuara prej shoqërisë “{***}” ShPK përfaqësojnë një kalendar të pagesave të kryera nga subjekti i rivlerësimit (përveç këstit të parë), të ndryshëm nga ai që ishte parashikuar të ndodhte sipas aktmarrëveshjes.
41. Kolegji konstaton se, pavarësisht kundërshtive mes të dhënave të nxjerra nga aktet më sipër, të gjitha faktet e servitura mbeten të lidhura me deklarimet e palëve, subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Kundërshtia me rëndësi për çështjen që është shtruar për zgjidhje lidhet me mandatpagesën nr. {***}, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka paguar këstin prej 32.680 eurosh më 21.03.2009. Kjo pagesë është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket kohës dhe vlerës së saj dhe gjithashtu edhe nga vetë shoqëria “{***}” ShPK, e cila në përgjigjet e sjella pas kërkesës

së subjektit, ka mbështetur me sqarimet e saj, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë fakt.

42. Ndodhur në këto kushte, Kolegji çmon se në mungesë të dokumentacionit provues ligjor, që do të provonte në mënyrë bindëse vlerën dhe kohën e pagimit të shumës prej 47.680 eurosh përgjatë vitit 2009, do të konsiderohen me vlerë provuese në kuptim të këtij procesi, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaratën periodike të vitit 2009, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.* Duke vijuar këtë arsyetim, Kolegji pranon se do të konsiderojë se pagesa e vlerës prej 47.680 eurosh, e kryer në vitin 2009, është realizuar përgjatë këtij viti, deri në datën 31.12.2009, siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit.
43. Në lidhje me çështjen e dytë, që ka të bëjë me përcaktimin e burimeve të përdorura prej subjektit të rivlerësimit për të mbuluar shlyerjen e shumës së mësipërme, Kolegji vlerëson të analizojë deklaratimet që subjekti i rivlerësimit ka bërë në deklaratën periodike të vitit 2009, si i vetmi dokument në të cilin gjejnë pasqyrim këto fakte. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit, siç është përshkruar më lart, ka përcaktuar se si burim i pagesës së shumës prej 47.680 eurosh kanë shërbyer të gjitha kursimet në vite të tij dhe të bashkëshortes, deri në datën 31.12.2009, një pjesë e huas së dhënë nga personi tjetër i lidhur z. A.Q. dhe shuma prej 1.500.000 lekësh, dhuruar bashkëshortes prej prindërve të saj.
44. Pretendimi i ngritur nga Komisioneri Publik në ankim për sa i përket këtij shkak, lidhet me faktin se, duke konsideruar që në të njëjtin vit subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në të njëjtën deklaratë gjendje likuiditetesh *cash*, në vlerën 1.400.000 lekë, ai nuk ka mundur të përballojë me të ardhura të ligjshme pagimin e kësteve të shtëpisë, shpenzimet e jetesës dhe krijimin e pasurisë likuiditet në këtë vlerë. Subjekti ka prapësuar këtë pretendim me arsyetimin se deklarimi i gjendjes *cash* i është referuar mundësisë potenciale të kursimit për atë vit, kursime që sipas po deklarimeve të këtij viti së bashku me të gjitha kursimet ndër vite, deri më 31.12.2009, janë përdorur si burim për pagimin e këstit të apartamentit.
45. Kolegji analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në këtë deklaratë, në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe situatës faktike konkrete. Sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj. Në deklaratën periodike të vitit 2009, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, brenda së njëjtës faqe të formularit të deklarimit, ka deklaruar shumën 1.400.000 lekë një herë si pasuri e krijuar *cash* dhe një herë si burim për shlyerjen e pagesës së shumës prej 47.680 eurosh. Ndodhur në këto rrethana, Kolegji çmon se situata faktike, ndonëse nuk është deklaruar saktë, duhet lexuar e kuptuar në linjën logjike që prapëson subjekti i rivlerësimit, për sa kohë që pavarësisht paqartësisë në deklarim, subjekti i rivlerësimit ka përshkruar ekzistencën e kësaj shume dhe destinacionin e përdorimit të saj. Pavarësisht se subjekti i deklarimit në mënyrë të pasaktë e ka deklaruar këtë shumë si gjendje *cash*

në datën 31.12.2009, ndërkohë që e kishte përdorur atë për të shlyer këstin e apartamentit dhe nuk duhej ta deklaronte si të tillë, Kolegji vlerëson se deklarimi i faktit që të gjitha kursimet në vite, deri në datën 31.12.2009, janë përdorur si burim për pagimin e këstit, përfshin edhe shumën prej 1.400.000 lekësh, të deklaruar si kursim *cash* i atij viti.

46. Duke përdorur dy konkluzionet e mësipërme, Kolegji kreu analizën financiare¹³ për subjektin e rivlerësimit për të verifikuar në përgjigje të shkakut të ankimit që u trajtua më lart, nëse subjekti kishte ose jo mundësi financiare të përballonte me burime të ligjshme pagimin e shumës prej 47.680 eurosh në vitin 2009. Në përfundim, Kolegji konstatoi se nga analiza financiare ai kishte një tepricë pozitive prej 416.900 lekësh, në ndryshim nga sa pretendon Komisioneri Publik për një mungesë të burimeve të ligjshme për shumën prej 1.041.085 lekë. Për pasojë, Kolegji arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit përballonte me burime të ligjshme pagimin e kësaj shume, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për pasojë e gjen këtë shkak ankimi të pabazuar.
47. Lidhur me shkakun e ankimit sipas të cilit Komisioneri Publik pretendon se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar pagesat për blerjen e apartamentit dhe shlyerjen e huas në vitet 2011, 2012 dhe 2013, Kolegji analizoi këto pretendime së bashku me prapësimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit ai ka pasur të ardhura të ligjshme për t'i përballuar këto pagesa, por se pretendimi i Komisionerit Publik, sipas tij, mbështetet mbi deklarime të subjektit të rivlerësimit, të cilat nuk janë interpretuar saktë, si edhe në analizën financiare të kryer në Komision për vitet 2011, 2012 e 2013.
48. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegji, rezulton se në deklaratat që subjekti i rivlerësimit ka kryer në deklaratat periodike të viteve 2011, 2012 e 2013, ai ka deklaruar shlyerje të vlerës së huas, marrë personit tjetër të lidhur respektivisht, shuma 7.000 euro në vitin 2011, shuma 5.000 euro në vitin 2012 dhe shuma 8.000 euro në vitin 2013. Në këto tri vite, përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu edhe krijim të pasurisë likuiditet, e krijuar prej kursimeve nga paga e shpërblimeve të tij dhe bashkëshortes, e gjendur në formën *cash*, te rubrika “Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, respektivisht 500.000 lekë në vitin 2011, 1.000.000 lekë në vitin 2012 dhe 1.450.000 lekë në vitin 2013.
49. Pas përfundimit të hetimeve paraprake, Komisioni në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën

¹³ *Analizë financiare: Viti 2009*

Totali i likuiditeteve në dispozicion: 9.002.296 lekë (në të cilat janë përfshirë: likuiditet në bankë në 1.01.2009, me vlerë 323 lekë; gjendje cash e akumuluar deri më 31.12.2008, me vlerë 2.900.000 lekë; të ardhura nga paga me vlerë 1.858.573 lekë; dhurim nga prindërit e bashkëshortes me vlerë 1.500.000 lekë, hua nga z. A.Q me vlerë 2.743.400 lekë).

Totali i shpenzimeve dhe i kursimeve të deklaruara: 8.585.396 lekë (në të cilat janë përfshirë: shpenzime për blerjen e apartamentit me vlerë 6.121.247 lekë; shpenzime minimale jetese, me vlerë 273.240 lekë; shpenzime udhëtimi me vlerë 96.019 lekë, shtesa cash në kursime, deklaruar e përdorur për blerjen e apartamentit 0.00 lekë; shpenzime likuidim interes huaje 5% në vlerën 9.748 lekë; likuiditete cash të mbetura nga huaja në vlerën 2.057.550 lekë).

Diferenca e likuiditeteve mes shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara = 9.002.296 lekë – 8.585.396 lekë = 416.900 lekë

e një rezultati negativ paraprak, që ka rezultuar nga analiza financiare e bërë në Komision për këto tri vite. Në zbatim të detyrimeve të tij ligjore për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo diferencë negative vjen për shkak se nuk janë lexuar drejt deklaratat e tij periodike. Në thelb të kësaj mbrojtjeje ka qëndruar argumenti se subjekti gabimisht ka deklaruar shtesa të pasurisë likuiditetet e gjeneruara *cash*, pa deklaruar zvogëlimet e kësaj pasurie në këto vite, pakësime të cilat kanë shërbyer për të përballuar shlyerjen e këstit të detyrimit për blerjen e apartamentit në vitin 2011 dhe shlyerjen e kësteve të huas. Komisioni ka pranuar në përfundim të procesit të pranojë këtë shpjegim të subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar në një situatë financiare pozitive.

50. Në gjykimin e çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit e shtjelloi dhe elaboroi më tej këtë qëndrim të tij, duke ndërtuar dhe prezantuar në gjykim analizën financiare sipas leximit e kuptimit që vetë ai i bën dokumentacionit dhe deklarimeve të marra në shqyrtim. Subjekti ka parashtuar se në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, plotësimi i deklaratave periodike është konceptuar si një minibilanc, në të cilin në njërin krah, te rubrika që përshkruhen pasurisë, vendosen *asetet* ose *aktivet* dhe në krahun tjetër, te rubrika që përshkruhen shpenzimet, përfshihen ato të deklarueshme, por edhe ato të cilat shfaqen në formën e detyrimeve ndaj personave të tjerë fizikë ose juridikë, që përfaqësojnë *pasivet*. Për këtë arsye, sipas këndvështrimit të subjektit, në rubrikën në të cilën shënohen shpenzimet apo detyrimet ndaj personave fizikë apo juridikë, nuk ka një zë që përshkruan burimin e përballimit të këtyre shpenzimeve, sepse natyrshëm ato përballohen nga burimet e përshkruara tek *aktivet* e këtij minibilanci. Në vijim të kësaj logjike, subjekti shpjegon se fakti që nuk ka përshkrim të burimit për të përballuar shpenzimet, në këtë rast shlyerjet e kredisë për tri vitet, kjo shumë e vendosur në këtë anë të *pasiveve* të këtij *minibilanci*, duhet të balancohet me shumën e vendosura në krahun e *aktiveve*, pra në ato të deklaruara si gjendje pasurie likuiditet apo të kursimeve, në mënyrë që dy krahet e bilancit të rezultojnë me gjendje zero në fund të tyre. Me këtë arsyetim, subjekti pretendon se ka shënuar si shtesë pasurie kursimet në *cash*, në një kohë kur një pjesë e tyre ishte përdorur gjatë vitit për të shlyer këstet e kredisë, dhe me të njëjtën logjikë ka përdorur kursimet e akumuluar deri në vitin 2011 për të shlyer plotësisht këstin e kredisë të këtij viti, për të cilin nuk ishin të mjaftueshme kursimet e vitit.
51. Subjekti gjithashtu ka ngritur para Kolegjit pretendime në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioneri Publik për sa i përket llogaritjes së disa shpenzimeve të zbritshme për shkak të udhëtimeve për motive të punës dhe të përfshirjes në gjendjen e deklaruar *cash* në fund të çdo viti, si edhe gjendjen e llogarive bankare të cilat kanë rezultuar nga ekstraktet e tyre, duke shpjeguar se sipas kuptimit të tij, me gjendje *cash*, është nënkuptuar e gjithë pasuria likuiditet.
52. Kolegji kreu analizën financiare për subjektin e rivlerësimit për të vlerësuar nëse me të ardhurat e deklaruara prej tij e bashkëshortes për vitet 2011, 2012 e 2013 kishte mundësi të përballonte kryerjen e shpenzimeve e të krijonte pasuritë e deklaruara prej tij.
53. Sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, u konsideruan si të mirëqena pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për motive pune, pretendime të cilat u mbështetën edhe me provat shkresore që subjekti i rivlerësimit

paraqiti gjatë gjykimit të çështjes¹⁴. Gjithashtu u konsideruan si të vërteta edhe pretendimet e tij se me deklaratimet e kursimeve në gjendjen *cash*, është përfshirë edhe gjendja likuiditet në banka në fund të çdo viti, deri në vitin 2011, duke qenë se nga analizimi dhe krahasimi i këtyre deklaratimeve në të gjitha vitet, nuk u konstatua asnjë rast i vetëm në të cilin, gjendja likuiditet në bankë të tejkalonte gjendjen e deklaruar si *cash*.

54. Në përfundim të kësaj analize, rezultoi se subjekti i rivlerësimit për vitin 2011 nuk kishte burime të mjaftueshme financiare për të përballuar shpenzimet e krijimit të kursimeve të tij, në shumën 586.542 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 1.173.955 lekë. Ndërsa, referuar situatës financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2012, nga analiza financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit mbulon shpenzimet me të ardhura të ligjshme. Rezultatet e kësaj analize financiare ishin përgjithësisht të njëjta dhe të mbështetura në të njëjtën logjikë me atë të kryer në Komision, me të cilën subjekti ishte njohur dhe për të cilën atij i ishte kaluar barra e provës. Për këtë arsye, duke qenë se subjekti në këtë analizë nuk do të përballej me asnjë element apo metodologji të re, të ndryshme nga ajo me të cilën ishte njohur e kishte debatuar në Komision, mbetet detyrë e Kolegjit të kryente mbi të njëjtat rezultate, analizën e tij ligjore në vlerësim të shkaqeve të ankimit. Kjo detyrë do të realizohej në procesin e marrjes së vendimit përfundimtar. Për sa më sipër, Kolegji refuzoi kërkesën e subjektit për t'u njohur paraprakisht me analizën financiare të kryer në Kolegj.

55. Në këtë analizë financiare Kolegji nuk pranoi si të bazuara shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për trajtimin dhe kuptimin e deklaratimeve të kryera prej tij. Në analizë të kuadrit ligjor të zbatueshëm për këtë çështje, Kolegji veçon nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003 i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese në kuptim të atij ligji, sipas përcaktimit që ky ligj kishte në mars të vitit 2012 e në mars të vitit 2014, kohë në të cilën është bërë deklarimi prej subjektit, sipas të cilit:

Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; [...]

d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;

e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale; [...].

Sipas kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të pasqyruar çdo ndryshim të këtyre të drejtave në çdo deklaratim periodik. Formulari i deklaratimit të pasurisë, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, përshkruan më tej mënyrën se si duhen deklaruar këto ndryshime duke detyruar subjektet të deklarojnë çdo ndryshim (shesë dhe pakësim) të interesave pasurorë dhe pasurive të paluajtshme dhe të

¹⁴ Prova nr. 6 – E-mail i një nëpunësi të Ambasadës {***}, datë 05.07.2019, për udhëtimin në muajin shkurt, në periudhën 7-27 shkurt të vitit 2009, që provon se ka qenë i organizuar nga Byroja e Çështjeve të Arsimit dhe Kulturës të Departamentit të Shtetit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në bashkëpunim me Programin “Çështje të zbatimit të ligjit”.

luajtshme. Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin ata mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar i cili duhet respektuar.

56. Në këndvështrim të kuadrit ligjor, subjekti ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurorë e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklarimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues.
57. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të viteve 2011 e 2013, vite të cilat rezultojnë me balancë negative nga analiza financiare, të pakësimeve të gjendjes *cash* dhe as të ndonjë destinacioni të përdorimit të kësaj gjendjeje në funksion të shlyerjes së ndonjë detyrimi, nuk është një gabim në deklarime siç pretendon subjekti, por tregon një panoramë të situatës financiare të subjektit, e cila tregon mungesë të burimeve të ligjshme për të përballuar në këto vite kursimet e krijuara dhe shpenzimet e kryera.
58. Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka koherencë në të kuptuarin e kësaj mënyre deklarimi që ai pretendon në gjykim, pasi në deklaratën periodike të vitit 2009 ai deklaron përdorimin e kursimeve për të shlyer pagesat për apartamentin, si dhe përdorimin dhe pakësimin e kursimeve të një viti më parë për blerjen e automjetit në vitin 2005. Me këtë mënyrë deklarimi, në përputhje me përcaktimet ligjore, subjekti demonstroi se ai nuk ka një koncept të ndryshëm nga ai që përcaktohet në ligj për mënyrën e deklarimit, por ai qartësisht deklaron pakësimin apo përdorimin e kursimeve e gjendjes *cash* për të justifikuar kryerjen e një shpenzimi. Arsyetimi i mësipërm mbështetet gjithashtu në vlerën provuese të deklaratave periodike sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe në situatën faktike sipas së cilës subjekti për deklarimet e bëra në deklaratat periodike të viteve 2011 e 2013 përdor për të mbështetur pretendimet e tij vetëm shpjegime të tijat, por të pashoqëruara me asnjë lloj dokumentacioni që do të provonte këtë qëndrim të tijin.
59. Kolegji vlerëson se pretendimi i tij që në vitet 2011 e 2013, pavarësisht se ka deklaruar gjendje *cash* në vlerat 500.000 lekë e 1.450.000 lekë, ai nuk i ka pasur këto gjendje sepse i ka përdorur për të shlyer detyrimet ndaj personit tjetër të lidhur, nuk lidhet me kuptimin e gabuar të plotësimit të deklaratës, por me argumentet që ka përdorur subjekti përgjatë deklarimeve në Komision e Kolegji për të shpjeguar balancën negative të këtyre viteve. Për pasojë, ky pretendim gjendet i pabazuar. Ky qëndrim i trupit gjykues është në koherencë me vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit në çështje që kanë trajtuar problematika të ngjashme.¹⁵
60. Në përfundim të analizës për këtë shkak ankimi, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, gjendjen

¹⁵ Vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR) dhe nr. 11/2019 (JR).

cash e për të përballuar shpenzimet e kryera për vitet 2011 e 2013 në shumën 1.760.497 lekë, duke u gjendur për pasojë përpara parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, përfundimisht ky shkak ankimi konsiderohet i drejtë dhe vendimi i Komisionit për këtë pjesë është i cenueshëm.

61. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nuk përballonin me burime të ligjshme shumën prej 1.500.000 lekësh, të dhënë dhuratë vajzës së tyre, Kolegji dëgjoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të kundërshtimeve të këtij pretendimi, si dhe mori me cilësinë e provës aktet e paraqitura prej tij¹⁶, të cilat provonin të ardhurat shtesë përtej atyre të provuara në Komision për personin tjetër të lidhur, z. K.N.
62. Komisioneri Publik, pasi dëgjoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe u njoh me provat e reja të paraqitura prej tij, në konkluzionet përfundimtare të çështjes parashtroi qëndrimin se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit mbulonin me të ardhura të ligjshme shumën prej 1.500.000 lekësh, dhënë dhuratë vajzës së tyre.
63. Kolegji gjithashtu kreu një vlerësim financiar për personat e tjerë të lidhur për të dhënat që rezultuan nga provat e reja të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, të cilat provonin një shumë më të madhe të ardhurash për këta persona dhe personin e lidhur, bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, gjatë kohës që ajo kishte qenë pjesë e familjes së origjinës. Nga vlerësimi i kryer në Kolegji, për të analizuar faktin nëse personat e tjerë të lidhur justifikonin me burime të ligjshme shumën prej 1.500.000 lekësh, u konsideruan të ardhurat e ligjshme të këtyre personave në raport me shpenzimet e konsumuara për jetesë, duke ndjekur të njëjtën logjikë kontrolli e verifikimi si te personi tjetër i lidhur, z. A.Q, dhe rezultoi se prindërit e bashkëshortes justifikonin me burime të ligjshme shumën prej 1.500.000 lekësh, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Kolegji gjithashtu vlerësoi se edhe mungesa e një kontrate formale dhurimi nuk përbën shkak për të vënë në dyshim ekzistencën e kësaj kontrate joformale, duke pasur parasysh marrëdhënien tejet të veçantë prind-fëmijë. Në përfundim, Kolegji e gjen të pabazuar këtë shkak ankimi dhe të drejtë vendimin e Komisionit për këtë pjesë.
64. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioni ka gabuar kur ka konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për të përballuar blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf 3” në vitin 2005, Kolegji pasi dëgjoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili prapësoi se ky automjet është blerë me të ardhurat e kursimet e vitit pararendës, 2004, dhe analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij në deklaratat periodike të vitit 2009, arriti në konkluzionin se ky shkak ankimi nuk qëndron.
65. Nga aktet e administruara në hetimin administrativ në Komision e në gjykimin në Kolegji, rezulton se automjeti tip “Volkswagen Golf 3”, i blerë më 29.07.2005 për vlerën prej 450.000 lekësh nga subjekti i deklaramit, nuk është deklaruar si pasuri e shtuar në deklaratën periodike të këtij viti. Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë aset në deklaratën periodike të vitit 2009, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, në formën e

¹⁶ Prova nr. 5: Vërtetim për pagën bazë të vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, të lëshuar nga “{***}” ShPK dhe të konfirmuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Nr. 10, Tiranë, për vitet 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009.

ndreqjes së një pasaktësie, harrese, në deklaratën e pasurisë të vitit 2005. Në këtë deklaratë ai ka deklaruar: *Nën përgjegjësinë time, për shkak ngatërrese në objekt në deklaratën e vitit 2005 nuk është deklaruar tjetërsimi i pasurisë në cash të vitit paraardhës për blerjen e një automjeti tip GOLF III, datë 27.07.2005, me vlerë 450.000 lekë (pakësuar 450.000 lekë).* Gjatë hetimit administrativ, subjekti në përgjigje të pyetjeve drejtuar nga Komisioni, është përgjigjur që kishte menduar se e kishte deklaruar automjetin dhe se e kishte konstatuar mosdeklarimin e tij në momentin kur i është dashur të evidentojë pasuritë që disponon veçmas nga bashkëshortja e tij. Ndërsa në lidhje me burimin e të ardhurave, ai ka shpjeguar se për blerjen e automjetit në vitin 2005, kanë shërbyer kursimet e tij nga paga dhe shpërblimet në vite nga Shkolla e Magjistraturës dhe detyra si prokuror.

66. Të njëjtin qëndrim mbajti subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë çështje edhe në gjykimin e çështjes në Kolegj, duke paraqitur si provë përveç sa ishin administruar në dosje, edhe deklaratën periodike të pasurisë së bashkëshortes së tij për vitin 2009, viti i parë në të cilin personat e lidhur unifikojnë deklaratimet si bashkëshortë, pas lidhjes së martesës në vitin 2009, vit në të cilin gjendet i pasqyruar i njëjti deklaram si ai që bën vetë subjekti në deklaratën e tij periodike për këtë vit.
67. Në mungesë të akteve apo provave të tjera për të qartësuar këtë moment, Kolegji referon analizën e tij të deklaratimit që subjekti dhe bashkëshortja kanë bërë në deklaratën periodike të vitit 2009 në lidhje me këtë aset, duke zbatuar nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Referuar këtyre deklaratimeve, dy janë konkluzionet që konsiderohen relevante për këtë çështje. Së pari, Kolegji çmon se mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i blerjes së automjetit në vitin 2005 është një pasaktësi e bërë në deklaratimin periodik të atij viti, i cili është ndrequr në vitin 2009, me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, kjo pasaktësi që i përket vitit 2005, e konsideruar si e tillë, nuk mund të shërbejë si një shkak i vetëm për të analizuar më tej drejt përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit. Së dyti, nga këto deklarime, subjekti i rivlerësimit ka referuar si burim të krijimit të kësaj pasurie, kursimet e krijuara nga vitet e mëparshme, pra duke përjashtuar të ardhurat e vitit 2005. Kolegji çmoi se kjo rrethanë fakti, e provuar nëpërmjet deklaratimeve si më sipër, duhet t'i nënshtrohej analizës financiare, duke qenë se nga hetimi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër që të mund të vinte në dyshim ekzistencën e saj.
68. Duke përdorur këto konkluzione, Kolegji kreu analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, referuar viteve 2003-2005, nga e cila rezultoi se ai kishte burime të ligjshme për të krijuar pasurinë likuiditet në gjendjen *cash* prej 700.000 lekësh në vitin 2004, një pjesë e së cilës ishte përdorur më pas për të blerë automjetin në vitin 2005, për një vlerë prej 450.000 lekësh. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, Kolegji çmoi se ai nuk qëndron, pasi rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për të përballuar blerjen e automjetit në vitin 2005, për pasojë vendimi i Komisionit edhe për këtë pjesë është i pacenueshëm.
69. Në lidhje me pretendimet e Komisionerit Publik të parashtruara në seancë gjyqësore lidhur me denoncimin e paraqitur prej tij bashkëlidhur me ankimin, sipas të cilit ai kërkoj verifikimin e të dhënave të parashtruara të cilat mund të afektonin vlerësimin e dy

kritereve të tjera, atij të figurës dhe të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, pasi dëgjoi edhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit, Kolegji vendosi të kryejë hetime në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, në drejtim të verifikimit të disa prej rrethanave të paraqitura në denoncimin bashkëngjitur ankimit, duke qenë se konkludoi se plotësoheshin kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, referuar informacionit të përcjellë me të.

70. Në denoncimin e paraqitur, rrethanat e konsideruara se përbëjnë shkelje të subjektit të rivlerësimit në mënyrë të përmbledhur janë:
- (i) subjekti i rivlerësimit, referuar deklarimeve të tij periodike, rezulton të ketë jetuar nën minimumin jetik, me të ardhura që nuk mjaftojnë as për shpenzimet mujore, si edhe pamundësia financiare e personit tjetër të lidhur, vjehrrit të subjektit, për t'i dhuruar bashkëshortes së subjektit shumën prej 1.500.000 lekësh;
 - (ii) subjekti, me kryerjen e disa procedurave “dyshuese”, brenda 3 muajve ka rritur vlerën e apartamentit të tij me 20.000 euro;
 - (iii) automjeti tip “Mercedes Benz” i deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në përdorim të tij, në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2016, është realisht në pronësi të tij. Shtetasi B.K. që ia ka dhënë këtë automjet në përdorim, ka pasur cilësinë e të pandehurit në vitin 2010, në një procedim penal i cili është hetuar dhe pushuar prej subjektit të rivlerësimit;
 - (iv) subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje të rënda të ligjit procedural penal, duke shpallur moskompetencën për hetimin e bandës kriminale të shtetasve S.Ç., E.B dhe S.S., duke shmangur kontrollin e gjykatës dhe duke krijuar në këtë mënyrë kushte favorizuese për këta të pandehur;
 - (v) ekziston dyshimi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar në vitin 2008 ose 2009 së bashku me personin nën hetim (shtetas turk) dhe avokatin e tij, z. V.M, i cili ka ndikuar në pushimin e hetimeve të çështjes.

Në lidhje me faktet e cituara në pikat (i) dhe (ii), Kolegji vlerësoi se nuk mund të ishin objekt i mëtejshëm verifikimesh, për sa kohë që të dyja këto rrethana i ishin nënshtruar hetimit dhe vlerësimit nga Komisioni, nën kontrollin e kriterit të pasurisë, dhe ishin konsideruar se nuk përmbanin elemente që mund të prodhonin përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit. Këto konkluzione u gjetën të drejta pas shqyrtimit që Kolegji u bëri rrethanave dhe fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ në Komision.

71. Kolegji, me vendimin të ndërmjetëm të datës 11.07.2019, vendosi të verifikojë tri rrethanat e tjera të pretenduara prej denoncuesit, të cituara në pikat (iii), (iv) dhe (v) të paragrafit më sipër, duke i drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme kërkesë për dhënien e informacionit për sa më poshtë:
- Nëse është regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasit B.K në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2010; dhe nëse po, a ka pasur subjekti i rivlerësimit pozicion procedural në këtë çështje.
 - Dhënien e informacionit mbi vendimin e moskompetencës të marrë nga Prokuroria për Krime të Rënda në lidhje me procedimin penal në ngarkim të shtetasve S.Ç., E. B. dhe S.S. në vitin 2017, dhe pozicionin procedural të subjektit të rivlerësimit në këtë vendimmarrje.

- Procedurën e pyetjes se shtetasit turk N.S. në territorin e Ambasadës Shqiptare në Ankara, për llogari të procedimit penal nr. {***}, datë 04.01.2008, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe mënyrën e përfundimit të këtij procedimi dhe pozicionin procedural të subjektit të rivlerësimit në këtë procedim.
72. Në përgjigje të kërkesës drejtuar nga Kolegji, Prokuroria e Përgjithshme dërgoi shkresën me nr. {***} prot., datë 15.07.2019, së cilës i ishin bashkëlidhur shkresa me nr. {***} prot., datë 12.07.2019, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresa me nr. {***} prot., datë 12.07.2019, e Prokurorisë për Krime të Rënda, së bashku me aktet procedurale që janë konsideruar relevante për çështjet.
 73. Fakti i pretenduar në denoncim se shtetasi B.K., pronar i automjetit në përdorim të subjektit të rivlerësimit, përdorim i deklaruar prej tij në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe i verifikuar prej Komisionit, ka qenë person nën hetim në një proces penal të ndjekur nga subjekti, nuk rezultoi i provuar. Referuar shkresës së Prokurorisë Tiranë, ky shtetas nuk figuron të ketë pasur çështje në ngarkim të tij në vitin e pretenduar, 2010, për pasojë edhe subjekti nuk kishte si të kishte një rol në favorizimin e tij, në këmbim të premtimit për dhënien në pronësi të makinës. Kolegji e gjeti këtë fakt të pavërtetë nga verifikimet e kryera, por duke pasur në vëmendje edhe hetimin e kryer nga Komisioni në lidhje me shtetasin B.K., për shkak të cilësisë së tij si person tjetër i lidhur, pikërisht për shkak të kësaj marrëdhënieje huapërdorje në lidhje me automjetin.
 74. Në lidhje me rrethanën tjetër të pretenduar në denoncim se subjekti i rivlerësimit ka luajtur një rol favorizues në raport me personat e hetuar në kuadër të veprave të rënda penale, S.Ç., E.B. dhe S.S., nëpërmjet konfirmimit të vendimit të moskompetencës së Prokurorisë për Krime të Rënda dhe dërgimit për kompetencë te Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga shkresat e ardhura prej Prokurorisë për Krimeve të Rënda, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar vetëm shkresën përcjellëse për këtë çështje, drejtuar Prokurorisë Elbasan, në mungesë të drejtuesit të kësaj zyre në ditën përkatëse, por nuk rezulton asnjë gjurmë që të tregojë për përfshirjen e tij si prokuror në këtë çështje apo për ndikimin e tij në çfarëdo mënyre në vendimmarrjen për shpalljen e moskompetencës së Prokurorisë për Krime të Rënda. Për këto arsye, Kolegji duke pasur parasysh edhe rregullimin ligjor në kohën e kryerjes së kësaj veprimtarie, në datën 01.10.2018, dhe aktivitetin krejtësisht administrativ dhe jo procedural të subjektit të rivlerësimit si drejtues i deleguar, në kuptim të normave të reja procedurale të miratuara me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale në maj të vitit 2017, e konsideroi edhe këtë rrethanë të përfshirë në denoncim si të pavërtetë dhe të pandikueshme në zgjidhjen e kësaj çështjeje.
 75. Në denoncim ishte pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar për në Turqi, për qëllime korruptive, me shtetasin V.M., avokati i një shtetasi turk, i cili ka qenë i pandehur në një çështje penale në të cilën subjekti i rivlerësimit ka qenë prokuror. Pavarësisht se Kolegji konstatoi nga përgjigjja e ardhur prej Prokurorisë së Përgjithshme se subjekti i rivlerësimit vërtet ka udhëtuar në Turqi në datën 11.08.2008, një ditë pas ditës në të cilën ka udhëtuar edhe Avokati V.M., dhe janë kthyer të dy në të njëjtën ditë, më datë 14.08.2008, por ky udhëtim është kryer për shkak të ushtrimit të funksionit të tij si

prokuror i çështjes penale në të cilën hetohej shtetasi turk (N.S) për veprën penale “Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, me qëllim pyetjen e këtij shtetasi si person nën hetim në ambientet e Ambasadës Shqiptare në Ankara. Gjithashtu, ky udhëtim rezultoi se ka qenë i autorizuar nga strukturat drejtuese të Prokurorisë së Përgjithshme dhe i financuar prej institucionit, duke u konsideruar si një udhëtim zyrtar. Për pasojë, edhe ky fakt i pretenduar në denoncim, pas verifikimit të kryer nga Kolegji, nuk rezultoi i vërtetë.

76. Në përfundim të hetimit të kryer për të verifikuar faktet e pretenduara në denoncim, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik, Kolegji konstatoi se ato nuk u provuan si të tilla prej hetimeve të kryera dhe se për pasojë nuk mund të konsiderohen relevante në lidhje me kontrollin e verifikimin e kriterëve të tjera të rivlerësimit, siç kishte pretenduar Komisioneri Publik në ankim.
77. Në përfundim të këtij gjykimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ankimi i Komisionerit Publik qëndronte dhe rezultoi i bazuar vetëm për sa i përket shkakut që lidhet me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të përballuar krijimin e pasurisë likuiditet, në formën e gjendjes *cash*, dhe të shpenzimeve për jetesë e shlyerjen e detyrimit ndaj personit tjetër të lidhur, në vitet 2011 e 2013, mungesë e cila e çon Kolegjin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Gentjan Osmani nuk ka justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë në pronësi të tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
78. Në funksion të një shqyrtimi në tërësi të kësaj çështjeje, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është gjithashtu subjekt rivlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016, dhe sqaron se ky vendim në asnjë mënyrë nuk paragjykon të drejtën e saj për një hetim të pavarur, të paanshëm dhe një rivlerësim në përputhje me ligjin nga organet e rivlerësimit. Vendimi i dhënë në këtë rast nuk do të afektojë drejtësinë dhe objektivitetin e procesit të rivlerësimit, të cilin bashkëshortja e subjektit ka të drejtë ta ketë, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së saj dhe në zbatim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit.
79. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet për vitet 2011 dhe 2013 e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, si një kriter që justifikon zbatimin ndaj tij të masës disiplinore, shkarkim nga detyra. Mbështetur në këtë konkluzion, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 61, datë 02.08.2018, nuk është dhënë mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve e analizë të duhur të ligjit, për pasojë ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 61, datë 02.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit Gentjan Osmani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 31.07.2019.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi